

Data 07.06.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i mirëmbatjes për Hibrid Mail”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT:

11,943,517 (njëmbëdhjetë million e nëntëqind e dyzet e tre mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, nenit 76:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3:

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre vitet e fundit, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e

mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, të lëshuara nga Organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001-2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente të vlefshme.
- ISO 27001:2013 (për Sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente të vlefshme

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Certifikatave

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ky kriter e siguron AK që Shërbimi që do të prokurohet do të jetë i cilësisë së lartë dhe sipas standardeve EU ISO 9001-2015 ose ekuivalente. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron AK që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Argumentimi: Ky kriter e siguron AK që Shërbimi që do të prokurohet do të jetë sipas standardeve në fushën e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2013 ose ekuivalente.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron AK që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

- Në rast të BOE secili O.E duhet të paraqesë ISO-t e sipërcituara në përputhje me zërat e shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin e tij punonjës të specializuar/të kualifikuar, të cilët duhet të figurojnë në Formularët E- Sig te listepagesat jo më pak se 3 (tre) muaj nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve.
- b) Minimumi 2(dy) punonjës në nivel inxhinier në degët elektronik/mekanik/IT, të çertifikuar për pajisje Production Océ Varioprint i200 ose ekuivalent .
- c) Minimumi 1 (një) punonjës të çertifikuar për Media Librari paper management .
- d) Minimumi 1 (një) punonjës të çertifikuar për Pajisje Server.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas DST.

Sqarim Lidhur me certifikimet, një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin).*

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe i referohet garancisë së Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimeve. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Punonjesit e mësipërm janë kërkuar sipas funksionit që do të kryejnë për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, për të treguar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Per piken a) kerkohen per arsyjen se :

Per te siguruar mbarevajtjen e kontrates nga aspekti i manaxhimit te proceseve dhe aktiviteve te parashikuara, gjate gjithë ciklit te tyre, eshte e domosdoshme nje ndjekeje rigoroze dhe e bazuar ne metodologji boterore, prandaj OE duhet te vere ne dispozicion te kontrates nje rmanaxher projektsh.

Per piken b) kerkohen per arsyjen se :

Duke gene se Pajisja qe do te kryeje printimin e fatuarave dhe dokumentave eshte e modelit Production dhe nuk eshte pajisje/fotokopje e thjeshte, per mirëmbajtjen e saj do te jete e

nevojshme qe operatori ekonomik te kete pjese te stafit te tij minimalisht 2 (dy) punonjes ne nivel inxhinierë Elektronik/mekanik/IT, me certifikimin e duhur nga prodhuesi i pajisjes qe do te ofertoje OSE EKUIVALENTE.

Specialistet , do te jene përgjegjës per:

- ✓ Sherbimin periodik.
- ✓ Pastrimin dhe nderrimin e pajisjeve te konsumit.
- ✓ Suport i stafit n e menyre dinamike sipas direktivave te prodhuesit.
- ✓ Axhornim i SW&HW
- ✓ Modification te bulletinit
- ✓ Preventive Maintenance , etj

Per piken c) kerkohen per arsyjen se :

Duke gene se pajisjet do te kryejne printimin e faturave apo dokumentave duke perdorur model ,format letre te ndryshe do te jete e nevojshme qe operatori ekonomik te kete pjese te stafit te tij minimalisht 1 (nje) punonjes të certifikuar per Media Librari paper management.

Specialistet , do te jete përgjegjës per:

- ✓ Te percaktoje llojet e letrës, peshat e letrës dhe kushtet e funksionimit të makinës (d.m.th
- ✓ furnizimi i letrës, temperaturat e shkrirjes, transferimi i tonerit, etj.) që janë të personalizuar për çdo brand.
- ✓ Rregjistrim letra të reja që mund të përdorni si një letër të personalizuar duke specifikuar emrin, madhësinë, llojin, peshën dhe të avancuara.
- ✓ Crrregjistrim te letres se personalizuar qe nuk do te perdoret.
- ✓ Konfigurime te letres sipas syrtareve te pajisjes.

Per piken d) kerkohen per arsyjen se :

Pajisja server Dell R640, per mirëmbajtjen e saj do te jete e nevojshme qe operatori ekonomik te kete pjese te stafit te tij minimalisht 1 (nje) punonjes me certifikimin e duhur nga prodhuesi i pajisjes qe do te ofertoje ose ekuivalent.

Specialisti , do te jete përgjegjës per:

- ✓ Monitorimin Periodik
- ✓ Sherbim ne rast difekti.
- ✓ Konfigurim dhe rifreskim i sistemit.

2.3.4 Operatori ekonomik për duhet te deklaroje qe ka stok pajisjet e meposhtme:

- i. Pajisje Oce Varioprint i200 ose pajisje te ngjashme ne funksione dhe specifikime.
- ii. Pajisje zarfimi Kern 686 ose pajisje te ngjashme ne funksione dhe specifikime

Ky kriter plotësohet me Formularin e Vetëdeklarimit sipas shtojcës së DST

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë: Deklaratë të posaçme për stokun e pajisje të sipërpërmendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. A.K kërkon garanci nga O.E për vijimin e shërbimit dhe realizimit me sukses të kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT